

Skuadrat tona

Në çdo vend, pritja sigurohet nga një skuadër profesionale.

Skuadra edukative mbështet dhe inkurajon...

Pjesëmarrjen e fëmijëve



Fëmijët sjellin idetë e tyre, krijojnë dhe zbatojnë projektet e tyre në mënyrë të mëvetësishme me mbështetjen e të rriturve.

Të drejtën për të qenë i ndryshëm



Të rriturit i shoqërojnë fëmijët që të jenë të hapur e tolerantë, me qëllim që secili e secila të gjejë vendin e vet të vërtetë.

Kënaqësinë për të qenë bashkë



Fëmijët gjejnë njëri tjetrin për të ndarë mendimet e tyre, për tu çlodhur dhe për të krijuar aktivitete sipas interesave të tyre.

Besimin



Besimi i të rriturve në aftësitë e fëmijëve mundëson thurjen e lidhjeve të forta dhe përjetimin e përvojave në një mjedis të qetë.

→ INFORMACIONET

Shërbimi i shkollave dhe ai jashtëshkollor
Drejtoria e fëmijërisë, rinisë dhe lagjeve
Place Chauderon 9 – 1003 Lausanne
021 315 64 11



www.lausanne.ch/parascolaire-7-8p



Ville de Lausanne

Shërbimi i shkollave
dhe ai jashtëshkollor

Pritja jashtëshkollore 7-8P

Një hapësirë ku kushtohet
koha që duhet



Shkurt...

→ Pritja jashtëshkollore 7-8P është një pritje jashtë orarit të mësimi që propozohet në shkollat që sigurojnë:

- Një skuadër edukative profesionale për shoqërimin e fëmijëve
- Mundësinë për të verifikuar praninë e fëmijëve
- Një vakt të baraspeshuar
- Aktivitete të larmishme
- Mundësinë për të bërë detyrat

Informacione praktike

- Hapur nga e hëna deri të premten, në mesditë e pasdite sipas orareve shkollore dhe të mërkurën deri në orën 14.00
- Vetëm me regjistrim prej prindërve në www.lausanne.ch/parascolaire-7-8P
- Vaktet janë të përfshira
- Çmimi sipas të ardhurave të prindërve



Një hapësirë për...

→ Të folur, për tu çlodhur, për të imagjinuar, për të shprehur mendime, për të hedhur projekte, për të takuar mike e miq

Pritja jashtëshkollore 7-8P në përditshmëri

Prindërit

- lajmërojnë skuadrën edukative në rast mungese, me mesazh ose telefon
- mund ta ndryshojnë kontratën për muajin vijues

Fëmijët

- mund të largohen nga hapësira e shkollës vetëm me pranimin e prindërve dhe të skuadrës edukative
- informojnë skuadrën jashtëshkollore nëse programi i tyre shkollor ndryshon (mbështetje, mësim fakultativ, këshill i të deleguarve, etj.)
- i hanë vaktet në mensë
- mund t'i bëjnë detyrat nën kujdesin e skuadrës edukative

Skuadra edukative

- i beson fjalës së fëmijës dhe e nxit mëvetësinë e tij
- duhet të dijë ku ndodhet fëmija